

## **AKTI “ÇDO NXENËS TË KETË SUKSES” (ESSA): Si ndikon kjo për Fëmijët nën Kujdestari**

### **Çfarë është ESSA?**

Akti “ Çdo fëmijë të ketë sukses” (ESSA) është një ligj Federal, i cili zëvendësoi Aktin “Asnjë fëmijë të mos ngelet Mbrapa” (No Child Left Behind) (NCLB) dhe i jep Shteteve fleksibilitet më të madh. Dispozitat për të rinjtë nën kujdestari në Filadelfia, do të vihen në zbatim për vitin mësimor 2017-2018.

### **Cili është qëllimi i ESSA për fëmijët që janë në kujdestari?**

ESSA zgjeron marrëdhëniet e bashkëpunimit midis Agjensisë për Fëmijët dhe të Rinjtë në Filadelfia, i cili është Departamenti i Shërbimeve Njerëzore (DHS), dhe Drejtorisë Arsimore të Filadelfias (SDP) për përmirësimin e shërbimeve dhe rezultateve për nxënësit nën kujdestari. Nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias, kërkohet të caktohet një pikë kontakti, që do të koordinojë dhe zbatojë këtë politikë të re.

### **Cili është roli i Koordinatorit të Kujdestarisë, në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias?**

Koordinatori shërben si hallka parësore e edukimit midis Drejtorisë Arsimore dhe DHS për Përcaktimet më të mira të Interesit, koordinimin e transportit dhe transferimeve të rekordeve apo caktimit në shkollë.

### **Cilat janë dispozitat përkatëse, të cilat sipas ESSA, ndikojnë tek fëmijët nën kujdestari?**

Drejtoria Arsimore e Filadelfias, në bashkëpunim me DHS do të garantojë si më poshtë:

- 1) Një fëmijë nën kujdestari, do të qëndrojë në shkollën e tij të origjinës (shkolla ku fëmija ka qenë regjistruar, në kohën e marrjes në kujdestari), me përjashtim të rasteve, kur merret një vendim, që përcakton se kjo gjë nuk është në të mirën e tij.
- 2) Nëse merret vendim se nuk është në të mirën e fëmijës, që ky të qëndrojë në shkollën e origjinës, fëmija do të regjistrohet menjëherë në shkollën e re, edhe nëse nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat e një regjistrimi normal.
- 3) Shkolla e re (ku do të regjistrohet) do të kontaktojë menjëherë shkollën e origjinës, për të marrë të gjitha rekordet mësimore dhe të tjera të kërkuara.
- 4) Transporti për fëmijët nën kujdestari ofrohet me mundësitë e ndarjes së kostos

